Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formulari i Ofertës, sipas Shtojces 1;
b. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1
c. Sigurimi i ofertes, sipas Shtojcës 3 (në vlerën 2% të fondit të marrëveshjes kuadër të Lotit);
ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;

d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;
dh.Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 7/1;
e.Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

3. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

3.1 Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një çertifikatë e vlefshme qe vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqerisë, **ISO 9001 ose ekuivalent** i tij. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
2. Çertifikatë e vlefshme e shoqërisë **ISO 22000 ose ekuivalent** i tij - Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
3. Certifikatë e vlefshme që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë ne pune **ISO 18001-ose ISO 45001 ose ekuivalent** i tij. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
4. Operatori ekonomik duhet te paraqese çertifikaten të vlefshme **ISO 14001 ose ekuivalent i tij** - Sisteme të menaxhimit të mjedisi. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 te VKM-914 date 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certefikata ISO sipas zërave te punëve/mallrave/shërbimeve qe do te marr përsipër te realizoj sipas aktmarrëveshjes.

3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit 2016, 2017, 2018, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit**.**

2. Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2016, 2017, 2018 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

3.3 Kapaciteti teknik

1. Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi per shërbimet e meparshme, te ngjashme, te realizuara gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ne nje vlere jo me te vogel se 40 % e vleres se fondit limit të lotit. Realizimi i shërbimeve të ngjashme duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë:

- Kur per shërbimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e shërbimeve ose faturat tatimore të shitjes.

- Kur per shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes ku të jenë shënuar datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të furnizuara.

2. Operatori ekonomik duhet te provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient, ku ushtron veprimtarine e sherbimit dhe gatimit te ushqimit, për të cilin duhet te paraqese dokumentacionin e mëposhtëm:
Dokumentacionin që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

- **Dokumentacioni që vërteton pronësinë:**
  - Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes/ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- **Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:**
  - Kontratë huaje.
- **Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:**
  - Kontratë qiraje.

a) Licencën e kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, lëshuar nga Qëndra Kombëtare e Biznesit.
b) Leje e mjedisit e tipit C, kodi III.1.A, lëshuar nga Qëndra Kombëtare e Biznesit, per zhvillimin e aktivitetit të gatimit dhe shperndarjes se ushqimit, per këtë ambient.
c) Akt miratimi higjeno – sanitar per këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.
d) Certifikate për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.
e) Operatori ekonomik duhet të deklarojë plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për ambientin ku ushtron veprimtarine e sherbimit dhe gatimit te ushqimit.

3. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 2(dy) automjete nga të cilët njëri prej tyre duhet të jetë frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore, të cilat mund ti ketë në pronësi ose me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës, si më poshtë:

- **Dokumentacioni që vërteton pronësinë:**
  - Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes/ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- **Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:**
  - Kontratë qiraje.

a) leje qarkullimi,
b) certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,
c) policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,
d) akt miratimi higjeno – sanitar.

4. Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 16 (gjashtëmbëdhjetë) persona të punësuar në

sektorin e shërbimit të ushqimit, të siguruar për periudhën Mars 2020 - Maj 2020. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqese:

- Një vertetim nga administrata tatimore për numrin mesatar te punonjësve për periudhën Mars 2020 - Maj 2020.
- Listepagesat (E-Sig 025) te konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën Mars 2020 - Maj 2020.

4.1 Punonjësit e punësuar në sektorin e shërbimit të ushqimit duhet të kenë minimalisht 1 vit eksperiencë pune sipas profesioneve në tabelën e meposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1	Kuzhinier	2
2	Mercollog/Kimist/teknolog	1
3	Ndihmes kuzhiniere/Shërbyes gatimi	11
4	Shofer	2
	Total	**16**

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Për kuzhinierin: diplome ose çertifikatë kualifikimi, kontrate pune, libreze pune, librezë shëndetsore.
b) Për mercollogun/kimistin/teknologun: diplomë ose çertifikatë kualifikimi, kontrate pune, libreze pune, librezë shëndetsore.
c) Për ndihmës kuzhiniere/Sherbyes gatimi: kontrata pune dhe librezat e punes, librezë shëndetsore.
d) Për shoferin: kontratë pune, librezë pune dhe leje drejtimi mjeti kategoria – B.
e) Punonjësit me profesionet e mësipërme duhet të figurojnë në listpagesat e operatorit ekonomik për periudhen e kerkuar.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), operatori ekonomik ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

6. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër me mjetet e veta gatimin dhe shpërndarjen e ushqimit për efektivat ushtarakë gjatë operacioneve /stërvitjeve/emergjencave jashtë vend dislokimeve të reparteve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Shënim: *Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 3.2, të kritereve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1, 3 dhe 4 të seksionit 3.3, të kritereve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më*

shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kritereve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kritereve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim

Shtojca 9

[*Shtojcë për t’u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE
PËR TË GJITHA LOTET (LOTI 1 DERI TEK LOTI 21)

Operatori ekonomik do të bëjë sigurimin e të gjithë artikujve ushqimorë sipas normave e kalorive të miratuara në VKM Nr. 88 datë 28.01.2008 “Mbi trajtimin me ushqim të efektivave në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Gatimi dhe përgatitja e ushqimeve nga operatori ekonomik do të bëhet brenda ambienteve të strukturave ushtarake. Ambienetet e reparteve mund të jepen me qira për t’u përdorur nga operatorët privat në bazë të akteve ligjore e nënligjore në fuqi dhe sipas VKM nr.54, datë.05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar.

1. Operatori ekonomik të disponojë mjete transporti frigoriferike, për transport të produkteve ushqimore, të cilat të jenë të pajisura me certifikatë higjeno-sanitare të lëshuar nga organet kompetente. Mjetet e transportit të jenë në pronësi ose me qera të vërtetuara me dokumente.
2. Operatori ekonomik të bëjë shpërndarjen e ushqimit të gatuar sipas orarit që do të përcaktohet në shtojcën “Termat e referencës”, për të tre vaktet e ngrenies së ushqimit në vendin e përcaktuar brenda repartit në bazë të planit të përhapjes së miratuar.

Furnizimi me uje, energji.

- Furnizimi me ujë, energji, do të kryhet në bazë të kontratave të lidhura nga kontraktuesi dhe ndërmarrjet përkatëse furnizuese. Për të garantuar vazhdimësinë e furnizimit me energji elektrike operatori ekonomik, të siguroje burime alternative furnizimi.
- Furnizimi me ujë të pijshëm do të bëhet nga rrjeti aktual i autoritetit kontraktor.

PROGRAMI USHQIMOR

1. Kërkesa për gatimin dhe përgatitjen e ushqimit

- Shërbimi i ushqimit do të serviret i ngrohtë në vendndislokimet e reparteve të Forcave të Armatosura në sasitë dhe kaloritë e përcaktuara me VKM nr. 88 datë 28.01.2008 “Mbi trajtimin me ushqim të efektivave në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

- Kontraktori mund të përdorë si alternativë e normat e zëvendësimit të mbështetura në tabelat e Urdhrit të MM nr.890, datë 18.06.2008 ”Për normat e zëvendësimit të artikujve ushqimore dhe normave të materialeve e të pajisjeve për gatim, ruajtje dhe shpërndarje të shërbimit të ushqimit në FA” vetëm në rastet kur këto zëvendësime janë pasqyruar në programin javor të ushqimit dhe shërben si alternativë e ushqimit të normës bazë .

- Nuk lejohet në asnjë rast dhe për asnjë arsye zëvendësimi nga operatori ekonomik i artikujve ushqimorë që janë të përcaktuara sipas normave të miratuara dhe programit ushqimor.
- Zarzavatet duhet të përdoren gjithmonë të freskëta dhe asnjëherë të konservuara si dhe duhet të plotësojnë kushtet përkatëse sipas STASH . Produktet ushqimore që do të përpunohen, do të depozitohen në ambientet e kuzhinës së Autoritetit Kontraktor dhe tëjenë të shoqëruara me fletë analizë përkatëse.

- Mishi duhet të jetë mish viçi, cilësi e parë dhe i shoqëruar me raport mjekësor veterinar, bazuar në specifikimet e pasqyruara në STASH 1441 /87.
- Llojshmëria e ushqimit do të jetë sipas sezonit, të përcaktuar në programin dhe menunë javore që hartohet nga struktura përgjegjëse logjistike në reparte, sasia e cilësia në bazë të normave, kalorive dhe zëvendësimeve të lejuara.
- Programi javor i ushqimit do të ketë dhe konfirmimin e operatorit ekonomik i cili do të zbatojë programin e menuse ditore dhe javore të ushqimit sipas programit të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.
- Programi ushqimor do te siguroje sasinë, cilësinë dhe kaloritë e duhura. Sasia dhe cilësia e ushqimeve qe furnizohen nga sipërmarrësi duhet tu përgjigjen kushteve qe përcakton Ligji Nr.9863 date 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar me Ligjin Nr.74, date 28.10.2013 “Per disa ndryshime dhe shtesa në nr.9863 date 28.01.2008 “Për ushqimin”.
- Personeli organik i operatorit ekonomik duhet të zbatojnë rregullat e brendëshme të autoritetit kontraktor dhe të pajisen me fletë-hyrje për të hyrë në repartet ushtarake që ushtrojnë aktivitetin e tyre privat.
- Kontraktuesi merr përsipër gatimin dhe shpërndarjen e ushqimit për efektivat ushtarakë gjatë stërvitjeve jashtë venddislokimeve të reparteve brenda teritorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Servirja e Ushqimit

- Shpërndarja e ushqimit do të bëhet nga operatori ekonomik me paisjet e tij në mensat e Autoritetit Kontraktor. Shërbimi do të kryhet me vetshërbim: me tabaka, luge, pirunj, thika, kartepiceta dhe gota. Në dispozicion të të gjithëve do të jetë një mbajtëse për mbajtjen e vajit të ullirit, uthullës, kripës, erëzave të ndryshme, kanave dhe gota për ujë natyral.

- Në përfundim të ushqimit kontraktori duhet të vendosë karroca të posaçme lëvizëse, të shperndara në sallë, për marrjen e tabakave dhe pjatat e palara duke lënë tavolinat e pastra për atë që do të vijë më pas.

3. Kërkesa higjeno-sanitare.

- Operatori ekonomik duhet të garantojë e sigurojë ushqim të freskët, të mbrojtur nga kontaminimet.

- Shërbimi shëndetësisë ka të drejtën e kontrollit sipas ligjit mbi inspektoriatin sanitar. Ushqimet do ti nënshtrohen kontrollit të analizave biologjike, kimike dhe fizike për të siguruar standardet e të ushqyerit.

- Operatori ekonomik të respektojë rregullat e higjienës për larjen pastrimin e zarzavateve, frutave etj. dhe përgatitjes së tyre për gatim.

- Personeli i kuzhinës dhe shpërndarjes së ushqimit duhet të jenë të pajisur me librezën përkatëse shëndetësore nga Inspektoriati i higjienes.

- Personeli i shërbimit të ketë uniformë ku të dallohet qartë logoja e operatorit ekonomik.

- Autoriteti kontraktor i përcakton operatorit ekonomik vendin e depozitimit të mbeturinave. Operatori ekonomik është i detyruar të depozitojë mbeturinat të ambalazhuara, në vendin e depozitimit të tyre (koshat e mbeturinave).

- Transportimi dhe evadimi i mbeturinave nga operatori ekonomik duhet të bëhet çdo ditë jashtë territorit të Autoritetit Kontraktor me mjetet e veta në vendet e përcaktuara nga bashkia/qendra administrative, zonës së përgjegjësisë.

4. Kërkesa te organizimit e menaxhimit te ushqimit (Kontrolli dhe forca ditore)

- Operatori ekonomik duhet që në çdo kohë të shoqëroje ushqimin e gatuar me dokumentacionin përkatës (fletë – dalje dhe bono) deri ne konsumimin e plotë të tij.

- Aktiviteti i sherbimit të shpërndarjes së ushqimit do i nënshtrohet kontrolleve nga Autoriteti Kontraktor për shërbimin e ushqimit dhe funksionimin e tij.

- Autoriteti Kontraktor ndjek zbatimin dhe realizimin e kontratës gjatë gjithë periudhës së kontraktuar dhe vendos sanksionet përkatëse për mosrealizime sipas përcaktimeve në kontratë.

- Autoriteti i kontraktuar është i detyruar të ruaje në kuti të veçanta në mjedisin e kuzhinës kampionet e ushqimit të gatuar e që shpërndahet për ngrënie për të tre vaktet. Afati i ruajtjes së kampioneve është 24-orë. Kur ka pretendime për cilësinë e ushqimit, ky afat zgjat deri në zgjidhjen e problemit.

- Operatori ekonomik me anë të strukturave përkatëse do të rakordojë me Autoritetin Kontraktor çdo muaj për racionet ditore të porositura sipas normave përkatëse, të bazuara në raport-situatat e lëshuara nga personeli i repartit, si dhe pasqyrës përmbledhëse mujore.

- Likujdimi i vlerës së ushqimit të gatuar do të kryhet në fund të çdo muaji në bazë të forcës ditore të porositur, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës të konsumit ditor, gjatë gjithë muajit, të përcaktuar në kontratë, sipas akt-akordimit mujor të firmosur nga të dyja palët (nga pala e repartit do të firmoset nga Specialisti i Furnizimit, personelit dhe shefi i logjistikës), në sasi dhe vlerë.

- Ushqimi i gatuar sipas normave, të shoqërohet me dokument dalje ditor.

- Ushqimi i gatuar duhet të shpërndahet nga Sipërmarrësi pasi të jetë kontrolluar dhe firmosur për çdo vakt, nga perfaqesues të Autoritetit Kontraktor në librin e kontrollit të ushqimit, i cili qëndron pranë kuzhinës dhe ruhet (nga ana e Oficerit Rojës).

TABELA E RACIONIT BAZE TE USHQIMIT DITOR

NE VLERE KALORIKE

Lidhja Nr.1- Norma ushqimore 3 vakte (4300 K/Kal)

Nr.	Artikulli	Njesia matese	Sasia me tre vakte	K/Kal me tre vakte
1	Bukë gruri masive	gr	600	1603
2	Oriz	gr	60	218
3	Makarona	gr	50	184
4	Fasule	gr	60	186
5	Mish viçi i freskët	gr	200	320
6	Vaj për gatim	ml	30	270
7	Vaj për sallatë	ml	10	90
8	Gjalp	gr	30	235
9	Sheqer	gr	50	196
10	Sallam ose proshutë	gr	50	231
11	Djath i bardhë	gr	40	123
12	Qumësht i freskët	ml	300	183
13	Vezë	kokrra	1	79
14	Perime për gatim	gr	350	130
15	Perime për sallatë	gr	150	60
16	Fruta të freskëta	gr	250	125
17	Reçel	gr	30	67
18	Salcë	gr	3	0
19	Çaj mali	gr	1	0
20	Kripë	gr	10	0
21	Erëza	gr	0	0
	Shuma			**4300**

TABELA E ARTIKUJVE USHQIMOR PER SHTESEN 500 KALORI

Lidhja Nr.2
Norma ushqimore shtesë (500 K/Kal)

Nr.	Artikulli	Njesia matese	Sasia	K/Kalori
1	Biskota	gr	50	250
2	Çokollata	gr	25	104
3	Veze	kokrra	1	79
4	Mish viçi i fresket	gr	42	67
	Shuma			500

TABELA E STRUKTURES USHQIMORE NË VLERE KALORIKE.

Lidhja Nr.3
Norma ushqimore 1 vakt (1738.8 K/Kal)

Nr.	Artikulli	Njesia matese	Sasia me një vakt	K/Kal me një vakt
1	Bukë gruri masive	gr	200	534
2	Oriz	gr	50	183
3	Makarone	gr	50	183
4	Fasule	=	=	=
5	Mishë viçi i fresket	gr	120	192
6	Vaj për gatim	ml	15	135
7	Vaj për sallate	ml	10	90
8	Gjalp	gr	10	75.8
9	Sheqer	=	=	=
10	Sallam ose Proshute	=	=	=
11	Djath i bardhe	=	=	=
12	Qumësht i fresket	ml	=	=
13	Veze	kokrra	1/2	39
14	Perime per gatim	gr	200	114
15	Perime per sallatë	gr	150	85
16	Fruta te fresketa	gr	200	108
17	Reçel	=	=	=
18	Salcë	gr	2	=
19	Çaj mali	=	=	=
20	Kripë	gr	5	=
21	Erëza	=		
	Shuma			**1738.8**

5. KËRKESAT PER PERSONELIN KRYESOR

- Operatori ekonomik merr përsipër kontrata të rregullta pune për personelin e shërbimit duke kryer pagesat e sigurimeve shoqërore.
- Të gjithë punonjësit e operatorit ekonomik duhet të jenë të pajisur me uniforme si dhe me shenja dalluese përkatese të shoqërisë.
- Operatori ekonomik duhet ti pajisi të gjitha mjetet dhe pajisjet me të gjitha shenjat dalluese të shoqërisë.
- Operatori ekonomik do të zëvendësojë çdo punonjës nëse Autoriteti Kontraktor konstaton se personi kryen veprime të jashtëligjshme ose është mjaft i pakenaqur nga puna e këtij personi.
- Punonjësit duhet të sillen me edukatë e kortezi si gjatë zhvillimit të shërbimit dhe gjatë qarkullimit brenda ambjenteve të repartit.
- Personeli do ta jeta i pajisur me libreza shjndetjsore nga Inspektoriati Sanitar Shëndetësor.

6. **Struktura organizative e personelit te shërbimit të ushqimit.** Për përgatitjen dhe shpërndarjen e ushqimit në strukturat e Forcave të Armatosura operatorët privat duhet të kenë në strukturat e tyre organizative personel si:

Kryekuzhinier/Kuzhinier; Ndihmës kuzhinier/ shpërndarës ushqimi; Teknollog ushqimor/ Merceolog ose kimist; Shofer.

Specifikime teknike për Ushqime Koloniale

Specifikime teknike për artikullin

“SHEQER”

Bazuar në STAZH…….....……..1413/87
Lloji: Sheqer
1. Pamja e jashtme: Pluhur i përberë nga kristale të imta dhe të njëllojta. Pa copa sheqeri të ngjeshura ose lëndë të huaja. Të jetë i derdhur i thatë në të prekur dhe të mos ngjitet .
Ngjyra: E bardhë dhe me shkëlqim.
Era dhe shija: Shije të ëmbël. Pa shije dhe erë të huaj dhe kur është kristal edhe kur tretet në ujë të pastër.
Tretshmeria: Tretet plotesisht në ujë. Tretësira është e tejdukshme dhe pa ngjyrë.

Treguesit fiziko kimikë:
1. Lagështira në % jo më shumë jo më shumë se …0.16 (për efekte ruajtje)
2. Sheqer i paster i llogaritur ne lende absolutisht të thate ne % jo me pak se 99.6.
3. Lëndë reduktuese (sheqer invert) ne % jo me shumë se 0.1.
4. Hiri në % jo më shumë se 0.07.
5. Përzierje hekuri me madhësi deri ne 0.3 mm,mg/1kg jo me shume se 3.
6. Ngjyra sipas njesive shtamore (llogaritur ne lende absolutisht të thate)ne % jo me shume se **1.**

Markërimi:
- Emërtimi i prodhuesit.
- Emri i produktit.
- Pesha neto ose vëllimi i produktit.
- Data e prodhimit.
- Data e skadimit (Data e jetëgjatësisë minimale).
- Kushtet e veçanta të ruajtjes.
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë.Këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.

Aambalazhimi: Të bëhet në thasë të pastër, të thatë polietileni, të qepur në grykë me masë 25-50 kg. Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet ne menyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

- Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jene të qarta, të dukshme mire, të pashlyeshme dhe lehtesisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
- N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jete lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.
- Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
- N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo eshtë e destinuar duhet të përdoret nje etikete shtese që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
- Në rastin kur etiketa është zevendesuar, apo plotësuar me nje tjetër shenimet e detyrueshme duhet të jene pikë për pikë si të etiketës orgjinale.
- Malli të shoqërohet me certifikatë orgjine dhe raportë analize të laboratorit.

Specifikime teknike për artikullin

“FASULE”

Bazuar në STAZH…….....……..1723/87

Lloji: Fasule të thata të bardha

Pamja e jashtme: Kokrra të shëndosha, të pastra në formë dhe madhësi sipas llojit.

Ngjyra: E bardhë

Era dhe shija: Karakteristikë e fasules së bardhë, të hidhur, pa erë myku dhe erë tjetër të huaj.
Pas zierjes ka ere të këndshme.

Treguesit fiziko kimikë:

1.Lagështira në % jo më shumë .....…15(për efekte ruajtje)
2.Lëndë të huaja jo me shume se.....0.8
3.Kokrra të thyera në % jo me shumë se.....13
5.Kokrra të verdha të pazhvilluara normalisht e të rrudhura në % jo më shumë se 1
6-Perzierje kokrrash ne % jo me shume se..... 2.2
7-Lëndë minerale..... nuk lejohen
8-Dëmtues hambari,demtimet nga insektet.....nuk lejohen

Amballazhimi: Të bëhet në thasë të pastër, të thatë polietileni, të qepur në grykë me masë 25-50 kg.

Markerimi:
Emërtimi i prodhuesit
Emri i produktit
Pesha neto ose vëllimi i produktit
Data e prodhimit

Data e skadimit (Data e jetëgjatësisë minimale)
Kushtet e veçanta të ruajtjes
Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.

Aambalazhimi: Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në menyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.
Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jene të qarta, të dukshme mire, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jete lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.
Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo eshtë e destinuar duhet të përdoret nje etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
Në rastin kur etiketa është zëvendesuar , apo plotësuar me nje tjetër shenimet e detyrueshme duhet të jene pikë për pikë si të etiketës orgjinale.
Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit.

Specifikime teknike për artikullin

“MAKARONA”

Bazuar ne STAZH…….....……..1170/87
Lloji: Makaronë e thjeshtë Spageti
Ngjyra: E bardhë me nuancë të verdhe. Ne thyerje paraqiten qelqore në jo me pak se gjysmën e siperfaqes së seksionit.
Era dhe shija: E mire,karakteristike e makaronave, pa shije të hidhur të thartë të mykur dhe pa erë tjetër të huaj.
Pas zierjes ka erë të këndshme.
Treguesit fiziko kimikë:

1. Lagështira në % jo më shumë .....13(për efekte ruajtje).
2. Aciditeti ne %,acid sulfuric jo më shumë se .....0.16.
3. Rritja e vellimit pas zierjes jo më pak se..... dy here.
4. Insekte dhe dëmtues të tjerë .....nuk lejohen.

Amballazhimi: Të bëhet në leter ambalazhi të paster ose polietileni me masë 1kg.
Në çdo pako shmangia e lejueshme..... ± 2%.
Markërimi:

- Emërtimi i prodhuesit
- Emri i produktit

- Pesha neto ose vëllimi i produktit
- Data e prodhimit
- Data e skadimit (Data e jetëgjatësisë minimale)
- Kushtet e veçanta të ruajtjes
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. Këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.

Aambalazhimi: Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet ne menyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

- Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
- N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jete lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.
- Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
- N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo eshtë e destinuar duhet të përdoret nje etikete shtese që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
- Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me nje tjetër shënimet e detyrueshme duhet të jenë pikë për pikë si të etiketës orgjinale.
- Malli të shoqërohet me çertifikatë orgjine dhe raportë analize të laboratorit.

Specifikime teknike për artikullin

“ORIZ”

Bazuar në STAZH…….....…..1738-87

ZV …….....…..1451-85, 1738-84
Grupi …….....…….K-12
KDU …….....664-71 “oriz”

Lloji: Oriz i zhveshur cilësia e parë.

1. **Pamja e jashtme:** Kokrra të shëndosha, të pastra .të zhveshura tëresisht nga lëvozhga e orizit, pa shënja myku ose prishje.
2. **Ngjyra:** E bardhë.
3. **Era dhe shija :**Karakteristike e orizit të shëndoshë, pa shije të thartë, të hidhur, pa erë
4. Myku dhe erë tjetër të huaj.

Treguesit fiziko kimikë:

1. Lagështira në % jo më shumë jo më shumë se ……..…15(për efekte ruajtje)

2. Lëndë të huaja (mel,farna të barnave të këqija, byk kashte, kokra boshe,etj % jo më shumë se 0.2

3. Kokrra jeshile të pazhvilluara në % jo më shumë se …….……..…….0.3
4. Kokrra të thyera më të vogla se gjysma në % jo me shumë se…….….. 12
5. Kokrra të kuqe në % jo më shumë se …….…….… 5
6. Kokrra të verdha në % jo më shumë se …….……. …2
7. Kokrra miellore në % ……..... ..... nuk lejohen
8. Lëndë minerale në % …… ..... nuk lejohen
9. Dëmtues hambari…….....nuk lejohen
10.Kokrra të prishura nga vetëngrohja, të mbira të prishura të nxira.....nuk lejohen
11.Kokrra të zhveshura…… .....nuk lejohen

Amballazhimi: Të bëhet në thasë të pastër, të thatë polietileni, të qepur në grykë me masë 25-50 kg.

Markërimi:

- Emërtimi i prodhuesit
- Emri i produktit
- Pesha neto ose vëllimi i produktit
- Data e prodhimit
- Data e skadencës (Data e jetëgjatësisë minimale)
- Kushtet e vecanta të ruajtjes
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktitushqimorë.këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.

Aambalazhimi: Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet ne menyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

- Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jene të qarta ,të dukshme mire ,të pashlyeshme dhe lehtesisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
- N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jete lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.
- Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
- N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo eshtë e destinuar duhet të përdoret nje etikete shtese që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
- Në rastin kur etiketa është zevendesuar, apo plotësuar me nje tjetër shenimet e detyrueshme duhet të jene pikë për pikë si të etiketës orgjinale.
- Malli të shoqërohet me certifikatë orgjine dhe raportë analize të laboratorit.

Specifikime teknike për artikullin

“VAJ ULLIRI ;STAZH 102-87”

Treguesit organo leptike: Pamja e jashtme të jetë e kthjellët dhe pa asnjë turbullire .

- Ngjyra të jetë e verdhë deri në lehtësisht jeshile. –
- Era dhe shija karakteristike të vajit të ullirit.

- Nuk duhet të permbajë lëndë të huaja, të jetë i rafinuar,aciditeti nuk duhet të kalojë 0.5 %. **Amballazhimi** ne shishe 0.5-1 litërshe qelqi ose plastike transparente me etiketë ku të shënohen standardet.

  Nuk duhet të jetë i perzier me vajra të tjerë dhe konservantë.
  Treguesit e tjerë fiziko kimik sipas STAZH.
  Markërimi:
  Emërtimi i prodhuesit.
  - Emri i produktit .
  - Pesha neto ose vëllimi i produktit.
  - Data e prodhimit .
  - Data e skadimit.

  Kushtet e vecanta të ruajtjes.
  Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë,këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.

Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit

Specifikime teknike për artikullin

“VAJ LULEDIELLI I RAFINUAR”

Bazuar në STAZH…...203 2003

1. **Pamja e jashtme:** Në gradë Celsius…lëng vajor i qartë pa depozitime.
2. **Ngjyra:** E verdhë e lehtë’
3. **Era dhe shija:** Karakteristikë e vajit të luledielli, e mirë, pa shije dhe pa erë të huaj.

Treguesit fiziko kimikë

1. Aciditeti i shprehur ne acid oleic jo më shumë se.....0.2 g\100g vaj
2. Masa specifike në 20 gradë Celsius …….....…0,918-0,923
3. Lageshtira dhe lendët fluturuese në 105 ^{0}C %, jo më shumë se…… 0,2
4. Numri i sapunifikimit në mg KOH\g vaj……...….188-194
5. Numri i jodit sipas Hanusit …….,……..…118-141
6. Lëndët e ptretshme në eter ose benzol, në %, jo më shumë se……..0.05
7. Përmbajtja e sapunve në %, jo me shumë se ……..……...0.005
8. Lëndët e pasapunifikueshme në jo më shumë se ……15g\kg
9. Numri i peroksideve jo me shume se ……10 mek O_2 aktiv\kg vaj
10. Treguesit e refraksionit…….…….……..….1,461-1,468
11. Përmbajtja e mikroelementve, mg\kg vaj jo më shumë se:

- Hekur ……..1,5
- Bakër……0,1
- Plumb ……..0,1
- Arsenik ……..0,1

Treguesit e mësipërm janë të detyrueshëm.
Ambalazhi: me kuti metalike të llakuara nga brenda me material të përshtatshëm për produkt, ushqimor ose shishe plastike (PET) me mase 1-5 litra me tapa metalike ose plastike me shirit PVC

me stampën perkatëse.
Shishet ambalazhohen në kuti kartoni të mbyllura mire ose me material tjetër të pershtatshëm.
Shmangia në vëllim është deri ± 1%.
Mbi çdo amballazh vendoset etiketa.
Aambalazhimi: Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet ne menyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

- Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jene të qarta, të dukshme mire, të pashlyeshme dhe lehtesisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
- N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jete lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.
- Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
- N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret nje etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
- Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me nje tjetër shënimet e detyrueshme duhet të jenë pikë për pikë si të etiketës orgjinale.

Markerimi: Në etiketë të përcaktohet emërtimi i produktit ushqimor vaj luledielli i rafinuar, emri i prodhuesit, lëndën e parë që përdoret për prodhimin e produktit ushqimor, kushtet e veçanta të ruajtjes, rekomandime.
Malli të shoqërohet me çertifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit
Në ambalazhim plastik ose metalik të vendoset data e prodhimit.
Data e skadencës (Data e jetëgjatësisë minimale)

Çdo parti malli të shoqërohet me çertifikatat origjine dhe raportë analize të laboratorit

Specifikime teknike për artikullin

“KRIPE E JODIZUAR”

Bazuar në STAZH…….....……..1437/01.07.1995
Lloji: Kripë ushqimore përpunuar dhe bluar për përdorim në kuzhinë.

Pamja: Masë kokrrizore
Ngjyra: E bardhë
Era dhe shija : E kripur pa shije dhe erë të huaj.
Treguesit fiziko kimikë:
1. Imtësia në mm .....0.2 – 2
2. Klorur Në lëndën e thatë ne %,.....jo me pak se 98
3. Klorur Mg në lëndën e thatë ne %,.....jo me shumë se 0.3
4. Sulfat Mg në lëndën e thatë ne %,.....jo me shumë se 0.9
5. Sulfat Ca në leëndën e thatë ne %,……..……jo me shumë se 0.2
6. Lëndë të patretshme në lëndën e thatë në %,……jo me shumë se 0.3

7. Lageshtirë në %,……...…jo me shumë se 1
8. Jodur kaliumi mg\kg…… 50 + - 3

Kripa të plotësojë të gjithë kërkesat higjeno shëndetsore dhe normat e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.
Amballazhimi: Të bëhet në qese të paster ose polietileni ushqimore, opak me masë 1 – 25 kg.
Markërimi:

- Emërtimi i prodhuesit
- Emri i produktit
- Pesha neto ose vëllimi i produktit
- Data e prodhimit
- Data e skadimit (Data e jetëgjatësisë minimale)
- Kushtet e veçanta të ruajtjes
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë.këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.

Aambalazhimi: Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në menyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

- Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë ,të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
- N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jete lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.
- Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
- N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo eshtë e destinuar duhet të përdoret nje etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
- Në rastin kur etiketa është zëvendesuar, apo plotësuar me një tjetër shënimet e detyrueshme duhet të jenë pikë për pikë si të etiketës orgjinale.
- Malli të shoqërohet me certifikatë orgjine dhe raportë analizë të laboratorit.

Specifikime teknike për artikullin

“MIELL GRURI”

Bazuar në STASH .....1455\87
Lloji: Miell gruri me rreze 80 %
Treguesit shqisor:
Ngjyra: E bardhë me nuancë të lehtë ne të verdhë në varësi të llojit të grurit.
Pjesezat e himeve janë të padukshme me rreze 80 %.
Era dhe shija: Karakteristikë e miellit të grurit, pa erë myku, pa shije të hidhur e të thartë dhe pa erë e shije të huaj. Nuk lejohen kërcitje.
TREGUESIT FIZIKE DHE KIMIKE

Lageshtira ,%, jo më shumë se..... 14
Aciditeti i shprehur në acid sulfurik në lëndët absolutisht të thata %, jo më shumë se.. . 0.115
Hiri i tretshem,në lëndën absolutisht të thate %,..... jo me shumë se 0.9
Hiri i patretshëm në acid klorhidrik l0%; në lëndën absolutisht të thate,%, ...jo me shume se 0.l
Mbisitja (imtësia e bluarjes):Për miellrat e bluar në fabrikat me cilindra:
Në sitën metalike nr.54,%,..... jo me shumë se 2
Ne sitën e mëndafshtë 5 xxx,%,.....jo me shumë se 5
Gluteni i njomë ,%, jo më pak se..... 25
Lënde minerale .....nuk lejohen
Perzierje metalike.Plumbi, zinku e bakri..... nuk lejohen
Lejohet permbajtja e hekurit në formë thërmijash nën 0.3 mm, ...jo më shumë se 3mg.g
Mikroorganizma patogjene, infestime dhe demtues hambari të gjallë,..... nuk lejohen
Ambalazhimi dhe transportimi.
Ambalazhimi bëhet në thasëpolietileni të paster të qepur në grykë me masë 25-50kg.
Mbi ambalazh vendoset etiketa ku shënohen të dhënat e mëposhtme.
Ndërrmarrja prodhuese.
Lloji i miellit.
Data e prodhimit dhe data e skadimit.

Ambalazhimi: Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në menyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.
Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë ,të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.
Transporti të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktorët atmosferikë duke zbatuar rregullat higjeno-sanitre per transportimin e produkteve ushqimore.

Specifikime teknike per artikullin

“BUKA”

Bazuar në STASH 1411/87

Lloji: Buke gruri me miell rreze 75 %

Treguesit shqisor

Korja: E lëmuar, pa flluska, pa çarje e pjesë të djegura dhe pa shkëputje të saj nga tuli, me ngjyrë të njellojtë mjalti në të kuqerremtë.
Tuli: Masë e njellojtë e pjekur mirë, jo e ngjitshme me pofre të shpërndara në menyrë të

njëtrajtshme dhe pa gjurmë mielli të pa brumosur. Kosinstenca elastike me shtypje të lehtë rikthehet në gjendjen e parë, jo i thërmueshme dhe pa shtresa.
Era dhe shija : E këndshme e bukës së pjekur mirë, pa erë e shije të hidhur, të thartë, myku ose të huaj. Nuk lejohet kërcitje.
Forma : E rregullt pa shtypje e deformime.
Lëndët e huaja : .....nuk lejohen.

Treguesit fiziko – kimik:

- Lagështira në % jo më shumë së 45
- Porozitetë në % jo më pak se 70
- Aciditeti në gradë jo më shumë se.....4.5

Buka dërgohet për konsum jo me parë se..... 3 ore nga koha e pjekjes
Masa e caktuar sipas llojit të bukes duhet t’i pergjigjet mases ...3-4 ore pas kohës së pjekjes
Ambalazhimi: Buka ambalazhohet në kuti plastike të lejuara për produktet ushqimore.

Transporti i bukes bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Specifikime teknike për artikullin

“REÇEL”

CILËSIA E I-rë
Treguesit cilësorë të recelit:
1.Pamja e jashtme: Jo e shëndritshme, e pasheqerosur, me sipërfaqe të njëllojtë, ku shënja myku dhe fermetimi nuk lejohen, pa pjesë të djegura, fletë fruit, fara dhe pjesë të fermetuara.
2.Ngjyra: E njëllojtë, karakteristike e frutave të përdorura të ziera me sheqer.
3.Shija dhe era: Me erë të pëlqyeshme, karakteristike e frutit që mbizotëron në përzierje, pa erë të huaj. Shija të jetë e pëlqyeshme, e ëmbël pa shije karamalizimi e fermetimi, pa shije të hidhur ose çfarëdo shije tjetër të huaj.
6 Treguesit kimik:
1..Lende reduktuese (sheqer invert) jo me shume se 0,1%.
2..Lageshtia jo me shume se 0,16%.
3..Hiri jo me shume se 0,07%.
Amballazhimi:
-Të jetë i ambalazhuar hermetikisht në kavanoza qelqi , apo plastike me peshë 1-5 kg,me etiketë.
Marketimi:
Emërtimi i prodhuesit.
Emri i produktit .
Pesha neto ose vëllimi i produktit.
Data e prodhimit .
Data e skadimit.
Kushtet e vecanta të ruajtjes.
Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit.

Specifikime teknike për artikullin

”SALCË DOMATE”

Bazuar në STAZH…….....……..1429\87

Lloji: Salcë domate

1.Pamja e jashtme: Masë e njellojtë me kosistencë paste, jo fibroze pa fara pa copa lekure pa pjese të karamelizuara të prishura ose të fermentura.

2.Ngjyra: E kuqe intensive karakteristikë e salcës së domates e njëllojtë në të gjithe masën

3.Era dhe shija: Karakteristikeë e domates pa shije dhe erë të huaj pa shije karamelizimi prishje ose fermetimi .

Treguesit fiziko kimikë:

- Përmbajtja e ekstraktit të dobishëm sipas refraktometrit në % .....28 – 30
- Aciditeti i Pergjithshëm në raport me ekstraktin i shprehur ne acid acetic ne% jo me shumë se 0.1.
- Përmbajtja e sheqerit të përgjithshem në % jo më shumë se..... 20.
- Kripra të klorurit të na të vetë lëndës së parë në % jo më shumë se 1.3……. 2
- Përmbajtja e acidit sorbik në mg\kg jo më shumë se .....600.
- Përmbajtja e metaleve të rënda në mg \kg jo me shumë se

- Zink 20
- Kallaj 250
- Plumb 0.4
- Baker 30
- Arsenik 0.4

Ngarkesa mikrobike. Brenda kufijve të lejuar nga Ministria e Shendetsisë.

Në salcën e domates nuk lejohen përmbajtje e lëndeve të huaja dhe përdoruesi i ngjuruesve artificial.

Amballazhimi, marketimi dhe etiketimi:

Ambalazhohet në kuti teneqeje të llakuara me masë…. 0.5 –1kg.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa e cila duhet të permbajë të dhënat e mëposhtme:

- Emërtimi i prodhuesit
- Emërtimi i produktit masa bruto, neto.
- Përmbajtja e produktit e menyra e perdorimit
- Afati i garancisë (data e prodhimit dhe data e skadimit)

Salca ruhet në mjedise të thata, të pastra, të ajrosura, temperaturë deri ne 28^0C, lagështirë deri në 75 % i mbrojtur nga rrezet e diellit.

Transportimi bëhet nga mjete të mbuluara, të pastra, të destinuara për transport të artikujve ushqimorë.

Aambalazhimi: Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet ne menyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

- Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jene të qarta, të dukshme mire, të pashlyeshme dhe lehtesisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
- N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jete lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.

- Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
- N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo eshtë e destinuar duhet të përdoret nje etikete shtese që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
- Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me nje tjetër shënimet e detyrueshme duhet të jene pikë për pikë si të etiketës orgjinale.
- Malli të shoqërohet me certifikatë orgjine dhe raportë analize të laboratorit.

Specifikime teknike për artikullin

“BISKOTA”

Biskota: Të jenë cilësore, me shije të mirë, pa shenja myku ose prishje, të jenë sipas standardeve shtetërore, të amballazhuara, me datë skadence mbi një vit nga data e furnizimit.

Specifikime teknike për artikullin

“ÇOKOLLATE”

Artikulli çokollatë të jetë një produkt industrial, të ketë për bazë kakaon, cilësore, me shije të mirë, pa shenja myku ose prishje, sipas standardeve shtetërore, e amballazhuar, me datë skadence mbi një vit nga data e furnizimit.

Specifikime teknike për artikullin

“ÇAJ MALI”

Lloji: Çaj mali.

Era dhe Shija: Erë dhe shije normale karakteristike e çajit. Cilësia: Të jetë cilësia e parë, e pastër nga barishtet dhe papastërtitë, pa lagështirë, me ngyrën karakteristike të tij të gjelbër të lehtë.

Amballazhimi:

Të jetë i amballazhuar.

<u>Specifikime teknike për Mish, Prodhime Mishi, Vezë.</u>

Për produkte mishi e të përpunuara operatorët ekonomik duhet të operojnë duke plotësuar standardet në fuqi për sigurinë ushqimore, kushtet që duhet të plotësojnë ushqimet me origjinë shtazore të cilat përcaktohen dhe sipas Dokumentit të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit i datës 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” dhe shtojcës 1, bashkëlidhur këtij dokumenti.

Specifikime teknike për artikullin

“MISH VIÇI I FRESKET”

Bazuar në STASH ..... 1441\87

Lloji: Mish viçi i freskët cilësia e parë

Kerkesat cilesore :

Pamja e jashtme: Sipërfaqja e mishit është e mbuluar me një cipë të hollë të thatë. Sipërfaqja e mishit pas prerjes është e lagur dhe e ndritshme, lëngu del me veshtiërsi dhe është i tejkudshëm. Tendinat jane të shndritshme elastike dhe të forta.
Ngjyra : Mishi i viçit ka ngjyrë rozë e ndryshme nga lopa që ka ngjyrë të kuqe dhe kau me ngjyrë të kuqe të mbyllur. Në prerje siperfaqja është e ndritshme, ngjyra e dhjamit është e bardhë tek kafshët e reja, ndërsa tek kafshët e rritura është e verdhë.
Era : E këndshme, karakteristike e llojit.
Ngjyra është rozë e verdhë.
Në prerje është e ndritshme.
Lengu i mishit pas zierjes : I tejdukshëm aromatik, në siperfaqe duket shtresa ose pika yndyrë.
Treguesit kimiko mikrobik :
1. Azot i tretshëm, në mg, Amoniak (NH3) për 100 gr produkt jo me shumë se.....20.
2. Aciditeti i shprehur në ph ..... 5.2 deri në 6.4.
3. Reaksioni per hidrogjenin sulfuror negativ.
4. Ngarkesa mikrobike brenda normave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.
Treguesit kimik e mikrobik analizohen vetem në ato raste kur dyshohet për ndryshimet që ka pësuar mishi.
Ambalazhimi dhe marketimi;
Çdo parti/karkasë mishi shoqërohet me çertifikatë veterinare, e cila garanton sigurinë e produktit “mish” dhe më të cilën vërtetohet se nga kontrolli i kryer nuk është prekur nga sëmundje, por që është i sigurt dhe se lejohet të tregtohet për konsum publik.
Vula e raportit veterinar të jetë e lexueshme mirë dhe çdo pjesë e karkasës (shpatull, kofshë dhe gjoks) duhet të jetë e vulosur me vulën e kontrollit veterinar.
Transporti i mishit brenda rrethit behet me mjete të mbyllura të pastra e të dezinfektuara posaçërisht për mishin me aparat matës temperature (taograf).

Transportimi jashtë rrethit të bëhet me autofrigorifer.

Specifikime teknike për artikullin

“KONSERVA ME MISH VIÇI”

Bazuar në STAZH….....…1544-87zv me 1544-79,3211-83
ZV …….....……..4003 –85
Grupi …….....…….J-13
KDU …….....……..664.93

Ky standard përcakton kërkesat kryesore me mish viçi të përgatitura me lëngun e vet, të ambalazhuara me kuti metalike (llamarine) të mbyllura hermetikisht dhe të sterilizuara.

Si lëndë e parë për prodhimin e konservave me mish viçi cilësia e parë.
Në të gjitha rastet mishi i freskët i therur të pajiset me çertifikatën e kontrollit veterinar.
Mishi për prodhimin e konsrvës përdoret në gjëndje të freskët (i ftohur) ose i çngrirë nga mishi i ruajtur në gjendje të ngrirë.
Më parë mishi seleksionohet nga të gjitha indet me vlerë të pakët.

Lëndët ndihmëse.

- Kripë gjelle e pastër
- Piper i zi kokërr
- Fletë dafine e dizifektuar dhe e tharë
- Kuti llamarine

Nr	Emertimi	Treguesit
1	Shija dhe era	Karakteristikë e mishit të vicit
2	Pamja e jashtme e kutise	E mbyllur, pa fryrje dhe deforminme mekanike,pa njolla oksidimi, pa dëmtime së shtresës së llakut ,lejohen njnolla ngjyre
3	Sasia e mishit ndaj masës së konservës në % jo më pak se	72
4	Yndyrna në % jo me pak se	13
5	Kripë në %	1-2
6	Përmbajtja e kriprave të metaleve të renda mg\kg jo më shumë se : Kallaj, bakri,zinku, plumbi,arseniku	200, 10, 70, 2, 1
7	Ngarkesa mikrobike	Brenda kufijve të lejuar nga Ministria e shendreetësisë.
8	Konsistenca e mishit	Normalisht të jete elastike dhe të ruaj strukturen morfologjike të indit.Ngjyra e lengut kafe e celur ne krem.

Amballazhimi, marketimi dhe etiketimi:

- Ambalazhohet në kuti teneqeje të kallaisura dhe të llakuara masa e kutise 100 - 500gr produkt.
- Mbi çdo kuti vendoset etiketa me mbishkrimin ;
- Emërtimi i prodhuesit.
- lloji i konservës(konservë me mish vici)
- Data e prodhimit, masa neto

Në çdo kuti vendosen etiketa ku shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit
- Emërtimi i produktit masa bruto, neto.
- Përmbajtja e produktit e menyra e perdorimit
- Data e prodhimit,
- Afati i garancisë (Data e jetëgjatësisë minimale)

Aambalazhimi: Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet ne menyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

1. Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jene të qarta ,të dukshme mire ,të

pashlyeshme dhe lehtesisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

2. N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jete lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.
3. Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
4. N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo eshtë e destinuar duhet të përdoret nje etikete shtese që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
5. Në rastin kur etiketa është zevendesuar, apo plotësuar me nje tjetër shenimet e detyrueshme duhet të jene pikë për pikë si të etiketës orgjinale.
